

Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

31 DHJETOR 2019

(Ky raport përmban 13 faqe)

Përbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur	3-5
Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Shfrytëzuara	6
Pasqyra e pozicionit finansiar	7
Shënimet e Pasqyrave Finançare	8-13

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Menaxhmentin e OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe, Prishtinë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (më tej si OJQ "EC Ma Ndryshe") që përbëhet nga Pasqyrën e të Ardhurave dhe fondeve të shfrytëzuar për periudhën 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 Dhjetor 2019, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale pozicionin financier të Organizatës me datën 31 Dhjetor 2019, si dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllt në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbrushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinion i ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme që Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion nëse është e zbatueshme për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur Menaxhmenti synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njojje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave,

por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

-Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.

-Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

-Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

-Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përvèç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

-Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

-Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përvèç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arësyen se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfititmet në favor të interesit publik.

Faruk Prebeza-- Auditor Ligjor
Faruk R. Prebeza
Auditor Ligjor

Ruga Sylejman Vuçitërrna, Kalabri, C1-42 , 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

21.04.2020


OJQ "EC Ma Ndryshe"

Nr. Fiskal : 600523783 NROJQ : 51108221


**Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Shfrytëzuara, për periudhën
01.01.2019 – 31.12.2019**

	2019	2018
Fondet		
Grantet (donacionet)	3 € 266,167.94	€ 187,516.00
Te Hyrat tjera		
Total te hyrat	€ 266,167.94	€ 187,516.00
Shpenzimet	4	
Pagat dhe mëditjet	€ 73,985.44	€ 78,551.30
Qiraja	€ 7,275.00	€ 7,835.87
Shpenzimet e Projekteve	€ 187,802.11	€ 94,942.82
Shpenzimet Administrative	€ 10,347.69	€ 15,483.87
Provisionet bankare	€ 649.96	€ 638.06
Auditimi	€ 500.00	€ 1,500.00
Tjera		
Total Shpenzimet	€ 280,560.20	€ 198,951.92
Mbetja e fondeve mbi shpenzimet	-€ 14,392.26	-€ 11,435.92
Paraja kesh dhe ne bankë ne fillim te periudhës	5 € 68,286.66	€ 79,722.58
Paraja kesh dhe ne bankë ne fund te periudhës	5 € 53,894.40	€ 68,286.66

Të autorizuar nga menaxhmenti:

Valon Xhabali

Drejtore Ekzekutiv



Admir Istrefi

Menaxher i financave


Pasqyra e pozicionit finansiar, më 31.12.2019

Asetet Rrjedhese:	Notes	2019	2018
Asetet Rrjedhese:			
Paraja në Arkë dhe në Bankë	5	€ 53,894.40	€ 68,286.66
Llogaritë e Arkëtueshme			
Kërkesat Tjera			
Total Asetet Rrjedhese:		€ 53,894.40	€ 68,286.66
Total asetet		€ 53,894.40	€ 68,286.66

Detyrimet dhe fondet e bartura

Detyrimet Afatshkurtra:			
Pagat e Pagueshme			
Llogarite e Pagueshme			
Tjera TMB dhe Kontribute		€ 0.00	€ 1,804.88
Total detyrimet afatshkura		€ 0.00	€ 1,804.88
Fondet e mbeturë	6	€ 53,894.40	€ 66,481.78
Total Fondet e bartura		€ 53,894.40	€ 66,481.78
Total Detyrimet, dhe fondet		€ 53,894.40	€ 68,286.66

Të autorizuar nga menaxhmenti:

Valon Xhabali

Drejtor Ekzekutiv



Admir Istrefi

Menaxher i Financave

Shënimë të pasqyrave financiare

Të përgjithshme

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe ("EC Ma Ndryshe"), është e themeluar në vitin 2006 me numër fiskal 600523783, dhe Adrese: ZEKI SHULEMAJA NR. 2. EC është organizatë e komunitetit që angazhohet për avancimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngashme, të cilat janë përgjithësisht të nën trajtuar në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikë bërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijojen mundësi për përfshirjen e politikë bërësve në një debat konstruktiv dhe të mirë informuar.

EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor.

Programet dhe Projektet e EC Ma Ndryshe gjatë vitit 2019

1. 'Qytetet Gjithëpërfshirëse' - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje
2. AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës
3. Re vitalizmi dhe integrimi socio-ekonomik i komunitetit lokal në rrugën Marin Barleti në Prizren
4. Standardet Evropiane për parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit
5. Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit
6. EKO Shkolla
7. RePublic Spaces
8. Treguesit e rijnë të trashëgimisë së Istogut
9. Studimi Baze për identifikimin e Rreziqeve dhe Përparësive Potenciale te Ndryshimeve Klimatike te Ndërlidhura me Çështje Gjinore për përfshirje ne Planin Urban Ndër sektorial te Intervenimeve për VLPK Urbane
10. Filigrani përtej Artizanatit
11. Ndotja nga Ndërtimi
12. Peticion për Mbrojtjen e Lumenjve
13. Monitoruesit e Mjedisit

1. Politikat Kontabël

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata dhe paraqesin një pamje të plotë të ngjarjeve ekonomike si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve që paraqesin fondet e marra dhe të shfrytëzuara.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas kontabilitetit akrual të orientuar prej SKK-ve të modifikuar me kontabilitetin mbi baz Cash-i për njojen e aseteve afatgjata materiale , amortizimeve të lidhura me to të cilat lidhen me aktivitetin jo fitimprurës të "EC Ma Ndryshe" të cilat janë njojur si shpenzime në momentin kur ato janë blere lidhur me projekte të caktuara.

Pasqyrat janë përgatitur duke respektuar tërësinë materiale, në harmoni me kushtet dhe kriteret e menaxhimit të granteve të dhuruara nga ana e donatorëve si dhe në kuptim me udhëzimet dhe këshillimet e termave kontraktuese me secilin donator veç e veç.

Organizata harton përbledhjen e shpenzimeve sipas linjave të buxhetit të projektit të miratuar për secilin projekt veç e veç duke përgatitur një pasqyrë të shpenzimeve të kryera (Raport Financiar) në zbatim të periudhave të raportimit të nënshkruar në kontratën e granteve. Në përgjithësi këto rregulla dhe procedura duke pasur parasysh specifikimin e

paragrafit të parë të këtij shënimini janë të orientuara nga Standardet Kombëtare dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK-ës).

2.2 Valuta Raportuese

Transaksionet e ndodhura tek OJQ "EC Ma Ndryshe" për këtë periudhë janë mbajtur në EURO.

3. Te hyrat e periudhës – Grantet (Donacionet)

Kodi i projektit	Donatori	Projekti	Të hyrat gjatë vitit 2019	Të hyrat gjatë vitit 2018
FLOSK ECP05/18	FLOSK	TechCamp Kosovo		4,220.93
KFOS ECP06/18	D4D	Aksione në komunitet për të promovuar lejen prindërore "në kuadër të projektit "Leja prindërore për barazi gjinore		800.00
KFOS ECP07/18	D4D	Organizimi I tryezës ne Prizren		350.00
OPIC ECP02/18; OPIC ECP03/19	Olof Palme International Center	Qyteti gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren	37,431.94	38,563.89
KCSF/ LUXECP01/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Akt Rural	65,760.00	40,760.00
KFOS ECP08/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Standardet Evropiane për parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit		9,940.00
KFOS ECP09/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit		9,850.00
EU ECP03/18	European Union	Revitalizimi I rrugës "Marin Barleti" Prizren		19,764.00
DRC ECP04/18	DRC	Revitalizimi I rrugës "Marin Barleti" Prizren		8,829.00
NED ECP07/17	NED	Rikthimi I Qytetit		19,949.20
UNDP ECP01/19	UNDP	Promotion and awareness raising activities on intangible cultural heritage in Kosovo	14,580.24	30,709.00
CIVIKOS ECP06/17	CIVIKOS	CIVIKOS-Qendra Rajonale Prizren		1,080.00
GAP Institute ECP10/18	GAP Institute	Premtimet e Komunave		2,500.00
KCSF ECP11/18	KCSF	Small grant		200.00
KFOS ECP06/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Monitoruesit e mjedisit	9,910.00	
KFOS ECP08/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Peticioni per mbrojtjen e lumenjeve	3,610.00	
KFOS ECP09/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Ndotja nga Ndertimet	10,000.00	
UNDP ECP05/19	UNDP	UNDP Hulumtimi	7,320.80	
UNDP ECP07/19	UNDP	UNDP Istog	10,804.00	
KCSF/NOR E02/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Eco School	38,820.00	
UN Habitat ECP04/19	UN Habitat	Republic Spaces	67,930.96	
Total			266,167.94	187,516.02

4. Shpenzimet sipas projekteve

Kodi i projektit	Donatori	Projekti	Pagat dhe Kontributet	Qiraja	Shpenzimet e Projekteve	Shpenzimet e Administrative	Provizionet bankare	Auditimi	Total Shpenzimet
OPIC ECP03/19	Olof Palme International Center	Qyteti gjithperfshires – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren	13,917.92	2,300.00	20,616.90	425.40	171.47		37,431.69
KCSF/LUXECP01/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Akt Rural	24,255.00	2,000.00	51,524.70	5,192.03	151.40		83,123.13
KFCOS ECP06/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Monitoruesit e mjedisit	3,250.00		6,157.50	485.00	14.60		9,907.10
KFCOS ECP08/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Peticioni per mbrojtjen e lumenjeve	450.00		3,050.00	100.00	10.00		3,610.00
KFCOS ECP09/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Ndotja nga Ndertimet	750.00				1.40		751.40
UNDP ECP01/19	UNDP	Promotion and awareness raising activities on intangible cultural heritage in Kosovo	5,000.00		39,513.08	416.96	79.80	280.00	45,289.84
UNDP ECP05/19	UNDP	UNDP Hulumtimi	1,600.00		5,380.80	326.00	13.20		7,320.00
UNDP ECP07/19	UNDP	UNDP Istog	1,999.99	200.00	300.00		5.00		2,504.99
KCSF/NOR E02/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Eco School	11,340.00	1,200.00	25,073.10	1,152.95	47.00		38,813.05
UN Habitat ECP04/19	UN Habitat	Republic Spaces	11,422.53	1,575.00	22,769.03	1,083.19	147.09		36,996.84
EU ECP03/18	European Union	Revitalizimi i rruges "Marin Barleti" Prizren			8,217.80	940.00	2.00		9,159.80

Emancipimi Civit Ma Ndryshe
Pasqyrat Financiare, Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

KFOS ECP08/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Standardet Europeane për parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit		2,000.00		3.00		2,003.00
KFOS ECP09/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit		3,199.20	26.16	4.00	220.00	3,449.36
KCSF ECP11/18	KCSF	Small grant			200.00			200.00
Total			73,985.44	7,275.00	187,802.11	10,347.69	649.96	500.00
								280,560.20

5. Paraja e gatshme

	31.12.2019 (ne EUR)	31.12.2018 (ne EUR)
Paraja kesh ne fund te periudhës	4,588.37	2,134.58
Paraja ne bankë ne fund te periudhës	49,304.73	66,151.36
Total	53,893.10	68,285.94

6. Fondet e mbeturë

Kodi i projektit	Donatori	Projekti	Bartja në fillim viti 2019	Te hyrat	Total Shpenzimet	Fondet e Mbetura
OPIC ECP03/19	Olof Palme International Center	Qyteti gjithperfshires – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren		37,431.94	37,431.69	0.25
KCSF/LUXECP01/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Akt Rural	28,817.01	65,760.00	83,123.13	11,453.88
KFOS ECP06/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Monitoruesit e mjedisit		9,910.00	9,907.10	2.90
KFOS ECP08/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Peticioni per mbrojtjen e lumenjeve		3,610.00	3,610.00	0.00
KFOS ECP09/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	KFOS Ndotja nga Ndertimet		10,000.00	751.40	9,248.60
UNDP ECP01/19	UNDP	Promotion and awareness raising activities on intangible cultural heritage in Kosovo	30,709.00	14,580.24	45,289.84	-0.60
UNDP ECP05/19	UNDP	UNDP Hulumtimi		7,320.80	7,320.00	0.80
UNDP ECP07/19	UNDP	UNDP Istog		10,804.00	2,504.99	8,299.01
KCSF/NOR E02/19	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile	Eco School		38,820.00	38,813.05	6.95
UN Habitat ECP04/19	UN Habitat	Republic Spaces		67,930.96	36,996.84	30,934.12
SDC/KCSF ECP06/15	SDC/Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Zhvillimi strategjik i EC Ma Ndryshe	(495.88)			-495.88
EU ECP03/18	European Union	Revitalizimi l rruges "Marin Barleti" Prizren	4,155.79		9,159.80	-5,004.01
KFOS ECP08/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Standardet Evropiane për parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit	1,799.58		2,003.00	-203.42
KFOS ECP09/18	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur	Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit	3,299.90		3,449.36	-149.46
KCSF ECP11/18	KCSF	Small grant			200.00	-200.00
Total			68,285.40	266,167.94	280,560.20	53,893.14